



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
REKTORI

Nr. 698 Prot.

Tiranë, më 20.05.2024

URDHËR

Nr. 80, Datë 20/05/2024

PËR

**ZHVILLIMIN E FUSHATËS ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJEN E AUTORITETEVE DHE
ORGANEVE DREJTUESE TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Mbështetur në nenin 36, pika 7, në nenin 39 si dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 131 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Urdhrin nr. 101, datë 13.03.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, në nenin 22, pika 6 dhe në nenin 27, pika 2 të Statutit të Universitetit të Arteve, në nenin 26 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Arteve”, të miratuar me Vendimin nr. 17 datë 29.03.2024 të Senatit Akademik të UART si dhe në Urdhrin e Rektorit nr. 46 dt. 05.04.2024 “Mbi shpalljen e ditës së fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e përcaktuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, për zgjedhjen e Autoriteteve Drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Arteve”,

URDHËROJ:

1. Fillimin e fushatës zgjedhore për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Arteve më datë 21 Maj 2024.
2. Përfundimin e fushatës zgjedhore 24 orë para ditës së zgjedhjeve dhe respektimin e periudhës së heshtjes zgjedhore, gjatë së cilës nuk lejohet asnjë lloj fushate.
3. Angazhimin e Administratorit dhe administratës së UART për krijimin e kushteve të përshtatshme dhe të barabarta të gjithë kandidatëve për të zhvilluar aktivitetet e tyre në kuadër të fushatës elektorale si dhe marrjen e masave nga ana e administratës së UART si dhe KIZ/KZF-ve për moscënimin e orëve të mësimin.
4. Ky urdhër i përcillet për njohje dhe zbatim Komisionit Institucional të Zgjedhjeve dhe Komisioneve Zgjedhore të Fakulteteve të Universitetit të Arteve si dhe një kopje i dërgohet Administratorit.
5. Ky urdhër të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. Kastriot ÇAUSHI